



GSRM

TREGU ME PAKICË I LETRAVE ME VLERË TË QEVERISË

Material Infomues

Letrat me Vlerë të Qeverisë

Letrat me vlerë të Qeverisë janë instrumente të borxhit afatshkurtër dhe afatgjatë të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë me qëllim financimin e deficitit buxhetor dhe investimeve publike.

Letrat me vlerë të Qeverisë sipas afatit të tyre ndahen në:

1. **Bono Thesari** – letra me vlerë të borxhit qeveritar me afat maturimi deri në 1 vit (3, 6 dhe 12 mujore);
2. **Obligacione Qeveritare** - letra me vlerë të borxhit qeveritar me afat maturimi mbi 1 vit.

Tregu Primar dhe Sekondar i Letrave me Vlerë të Qeverisë

Letrat me vlerë të Qeverisë (bonot e thesarit dhe obligacionet) emetohen nga Ministria e Financave në emër e për llogari të Republikës së Shqipërisë.

Vendi ku emetohen për herë të parë letrat me vlerë të Qeverisë quhet "*treg primar*". Ankandet e tregut primar të letrave me vlerë të Qeverisë në Republikën së Shqipërisë organizohet në Bankën e Shqipërisë.

Çdo transaksion tjetër në letrat me vlerë të Qeverisë që ekzekutohet pasi ato janë emetuar në tregun primar quhet "*treg sekondar*". Në Republikën e Shqipërisë ekzistojnë më shumë se disa tregje sekondare të këtyre instrumenteve si: tregu ndërbankar i letrave me vlerë të Qeverisë, tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë, si dhe tregu në Bursën e Tiranës.

Ç'është Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë

Tregu me pakicë i letrave me vlerë të Qeverisë është *tregu sekondar* i organizuar në sportelet fizike apo virtuale të subjekteve të licensuara për kryerjen e transaksioneve në këto instrumenete me investitorët.

Tregtimi në Tregun me Pakicë

Në tregun me pakicë mund të ushtrojnë veprimtarinë e ndërmjetësimit për llogari të tyre dhe të të tretëve vetëm ato banka apo subjekte të tjera të licensuara nga Autoriteti i

Mbikëqyrjes Financiare. Investitorët e mundshëm në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë mund të jenë, persona fizike ose juridike, rezidente dhe jorezidente.

Të gjithë investitorët të cilët dëshirojnë të kryejnë transaksione në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë, duhet të kontaktojnë patjetër me një ndërmjetës financiar, i cili duhet medoemos të jetë subjekt i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Llojet e Transaksioneve në Tregun me Pakicë

Transaksionet që mund të kryhen nga bankat dhe subjektet e tjera të licensuara në tregun me pakicë janë:

- Blerje të bonove të thesarit në tregun primar (ankand) nga investitori nëpërmjet bankës, apo subjektit të licensuar;
- Shitja e letrave me vlerë të qeverisë investitorit nga portofoli i bankës, apo subjektit të licensuar ;
- Blerja e letrave me vlerë të Qeverisë nga banka apo subjekti i licensuar para datës së maturimit nga çdo investitor, pavarësisht nëse veprimet e mëparshme nuk janë kryer nga e njëjta bankë apo subjekt i licensuar;
- Vendosja e letrave me vlerë të Qeverisë si kolateral;
- Shlyerja e vlerës nominale në datën e maturimit.